



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Të mbledhjes së parë të Komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara, mbajtur më 05.09.2019, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Mehreme Llumnica, Ramadan Salihu, Fatime Demolli - Mustafa, Gyltene Retkoceri, Jeton Tanhasi dhe Premtime Preniqi, koordinatorë e Njesisë për të drejtat e njeriut.

Munguan: Ermira Shabani dhe Armend Ademi.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Premtime Preniqi.

Ajo tha se është koordinatorë e Njesisë për të drejtat e njeriut. Sa i përket këtij komiteti, gjatë takimeve çdo herë do të jem në ndihmesë të këtij komiteti, më tepër në aspektin logjistik, gjegjësisht në aspektin e informimit që e kemi si njësi, mirëpo pjesa tjetër e punës, orari dhe plani i punës së këtij komiteti mbetet pjesë e juaja.

Unë e hapa këtë mbledhje, meqë tash për tash këtij Komiteti i mungon kryesuesi ose kryesuesja. Edhe pse mungojnë dy anëtarë të Komitetit, kjo nuk është pengesë për t'u zgjedhur kryesuesi në këtë takim. Unë e konsideroj pozitive punën që e ka zhvilluar Komiteti që ka qenë në mandatin e kaluar. Keni parasysh se pjesa më e madhe e anëtarëve të Komitetit që jeni tash, në mandatin e kaluar keni qenë anëtarë të këtij komiteti. Pra janë shtuar edhe tre anëtar të rinj, që e bëjnë Komitetin edhe më funksional dhe më të përgjegjshëm.

Ky komitet përbëhet nga 7 anëtarë dhe mbledhjet mbahet 1 herë në 2 muaj. Për këtë bëhet një pagës simbolike prej 50 €, mirëpo brenda kësaj hapësirës dymujore Komiteti mundet me marrë aktivitete tjera, faktikisht nuk paguhet, por ka mundësi të ndryshme që mundën me u financuar prej Komunës. Në mandatin e kaluar ka qenë Mehrem Llumnica kryesuese e këtij Komitetit, tani ju propozoni dhe vendosni se kush do të jetë në këtë mandat.

Ky mandat është trevjeçar. Ndoshta keni marrë informata se është një Plan i veprimit lokal, që i ka mbetur për monitorim, por kemi mbetur mbrapa për monitorimin e tij, andaj është mirë me vazhduar që sa më shpejt me filluar.

Faqe 1 nga 7



Fatime Demolli - Mustafa kërkoi që të prezantohen anëtarët e Komitetit.

Gyltene Retkoceri, magjistër e psikologjisë, me eksperiencë në fushën e psikologjisë, kryesisht me personat me nevoja të veçanta dhe si psikologe klinike në organizata të ndryshme.

Ramadan Salihu, nga komuniteti t të verbërve, me profesion jurist.

Mehrema Llumnica, përfaqësuese e personave me aftësi të kufizuara fizike, pjesëtare e stafit "Hendikos", me profesion i takoj fushës së shëndetësisë. Kontributi im ka qenë i madh, ku kam pasur angazhim të madh, së pari në rritje të kapacitetit tim personal dhe profesional, sepse shëndetësia ka të bëjë me aftësinë e kufizuar dhe puna në "Hendikos" e ka avancuar ende profesionin e shëndetësisë, në fusha të legjislacionit dhe shërbimeve sociale. Kam dhënë kontribut në hartimin e planeve në grupe punuese, kështu që gatishmërinë e kam me bashkëpunuar, por tash kryesuese nuk do të jem.

Jeton Tanhasi, inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë, pronar i kompanisë "ARHING".

Arsyeja që jam angazhuar në këtë Komitet, është se jam prind i një vajze hendikep dhe kam njohuri çka ju nevojitet këtyre personave, jam ideator i liftit të këto ndërtesat 4-5 katëshe pa lifte. Kushdo që ka nevojë për projekt, unë jam i gatshëm t'ia bëjë projektin falas.

Gyltene Retkoceri propozoi që të jetë kryesuese Mehremja, pasi që ka qenë edhe më herët dhe është në rrjedha të këtyre gjërave.

Mehreme Llumnica e falënderoi parafolësen, duke thënë se nuk mundem më të jam kryesuese për shkak të obligimeve personale. Jam e gatshme të japë kontributin dhe të bashkëpunojë me të gjithë. Ajo propozoi që të jepen propozimet dhe të votohet, dhe propozoi që në këtë garë të jetë Ramadani, sepse ka përvojë dhe ka dhënë kontribut të madh, kemi bashkëpunuar shumë mirë dhe është njohës i ligjeve, dhe propozimin e dytë për Gyltenen, se është më e re. Ndoshta kishte qenë mirë një kryetar dhe një nënkryetar bashkë.

Ramadan Salihu propozoi që me vazhduar edhe një mandat Mehremja.

Jeton Tanhasi u shpreh se, pasi që kryesuesja u deklarua se nuk po ka mundësi me vazhduar mandatin, unë e propozoj Gyltenen, por edhe zotëri Ramadanin e kisha propozuar, pasi që edhe ka qenë anëtar edhe më herët.

Premtime Preniqi dhe **Mehreme Llumnica** dhanë sqarime lidhur me punën e kryesuesit të Komitetit.

Gyltene Retkoceri shprehu mendimin se më mirë do të jetë nëse zgjidhet ndonjëri nga anëtarët që ka qenë edhe në mandatin e kaluar.

Fatime Demolli - Mustafa e propozoi Ramadanin, për arsye se e njeh mirë legjislacionin dhe ka qenë për 3 vjet anëtar i Komitetit, e njeh punën, kështu që shumë më lehtë është për një anëtar të vjetër sesa të ri.

Ramdan Salihu bëri një falënderim për vlerësimet që patën kolegët ndaj tij. Ai tha se nëse përfundimisht ti Mehreme nuk dëshiron të vazhdojë, atëherë unë po kërkoj konsensusin për Fatimen. Ai shprehu mendimin se sa ka punuar Komiteti për tri vjet, OJQ-të nuk kanë punuar për 30 vjet.

Fatime Demolli - Mustafa, falëndero Ramadanin duke thënë se me kënaqësi iu kisha propozuar juve për kryesues të Komitetit. Arsyeja e vetme që unë mos me qenë në këtë pozitë është për shkak të obligimeve që kam.

Jeton Tanhasi propozoi që Fatimja ta marrë këtë obligim.

Fatime Demolli - Mustafa u pajtua që të jetë kryesuese e Komitetit.

Në bazë të propozimeve të anëtarëve, u vendos që kryesuese e Komitetit për këtë mandat 3-vjeçar të jetë Fatima Demolli - Mustafa.

Premtime Preniqi i uroi suksese znj. Fatime Demolli - Mustafa në detyrën e re.

Fatime Demolli Mustafa falënderoi pjesëmarrësit për besimin e dhënë.

Ajo në vazhdim tha se ajo çka kisha kërkuar prej Komunes, meqë në këtë rast të kemi ty Premtime këtu, të gjithë anëtarët e Komitetit Komuna mundësisht me i pajisur qoftë me një kartelë identifikuese, qoftë me një dokument shtesë tjetër, që jemi anëtarë të Komitetit, që kur të dalim në terren apo takime, vizita të ndryshme, ta arsyetojmë para një kompanie, para një drejtori, udhëheqësi se kush jemi ne. Më konkretisht, më ka rënë me shkuar te IP "Yllkat", që është duke u ndërtuar, edhe pse e ka ndërtuar Bashkimi Evropian, si objekt shumë i mirë, por nuk ka qasje të duhur për fëmijët me aftësi të kufizuara, e kam pasur të pamundur me u takuar me kryesuesin e punime, për shkak se nuk e kanë njohur pozitën time dhe, në njëfarë mënyre, nuk kam pasur se si me e dëshmuar se kush jam, për çka jam, çka po dua dhe për çka kam ardhur. Mund të them se kjo pak na ka ndaluar si Komitet me bërë hapa të tillë, se nuk kemi pasur me çka të identifikohemi.

Premtime Preniqi sugjeroi që si Komitet duhet shikuar se cila drejtori e ka këtë proces të punimit të kartelave, kështu që ju duhet me u takuar drejtpërdrejt me atë drejtori dhe nuk besoj që është një proces i vështirë puna e një karteje identifikuese.

Jeton Tanhasi dha një propozim, duke thënë se është i nevojshëm një raport lidhur me punën e këtij komiteti në mandatin e kaluar.

Premtime Preniqi tha se Ramadani e ka bërë një raportim në Kuvend dhe mundet me ua sjellë, Mehremja i ka pasur raportet e punës, kështu që në mbledhjen e ardhshme ju sjellin, po ashtu në ueb - faqe të Komunes i ke të publikuara.

Mehreme Llumnica bëri një përmbledhje të shkurtër të punës që është bërë në mandatin e kaluar. Kemi bërë Planin e punës, ku kemi pasur pikat kyçe. Së pari, kemi pasur me u takuar me zyrtarë komunalë, me dikasteret si me Drejtorinë e Arsimit, Drejtorinë e Mirëqenies Sociale, problematikat për qasje për regjistrim me pagesë, pa pagesë etj.

Kemi kontaktuar edhe me zyrtarë jashtë Komunës, p.sh. të Qendrës së karrierës, shkollave, por zakonisht kyçe kanë qenë burimet këtu që janë të posaçme për me i drejtuar problemet. Me Zyrën e burimeve njerëzore, e kemi bërë që në aplikacionet për punë të futet edhe një rubrikë, të specifikohet që është PAK jo për me diskriminuar anën negative, por për pozitivitet, dhe në kushte të barabarta me i dhënë një prioritet ose me u njoftuar së paku që është PAK, për me u zbatuar Ligji, që parasheh 50:1 të punësuar. Kemi bërë një hulumtim se sa janë të punësuar në Komunën e Prishtinës dhe me prioritet e kemi marrë edhe punësimin dhe gjithë përfshirjen në shkollim dhe qasjen në infrastrukturë. Me Drejtorinë e Administratës kemi pasur një bashkëpunim të mirë, na ka përkrahur që edhe në ueb-faqen e Komunës "Prishtinaonline", të jetë edhe pasqyra dhe puna e Komitetit.

Kemi pas një plan veprimi, si me bërë një vizitë studimore jashtë vendit. Do ta kemi një plan veprimi për ditët e shënuara dhe me dalë me një hulumtim, siç kemi dalë nëpër kompani, nëpër institucione të komunës tonë, së pari te administrata, nëpër shkolla edhe në QMF, për të parë se sa është numri i të punësuarve të PAK në Komunën e Prishtinës. Ka dalë një numër shumë i ulët dhe ato hulumtime i kemi prezantuar. Me Kuvendin e Komunës kemi dalë me një raport dhe synim e kemi pasur hartimin e Planit të veprimit të PAK, për planin trevjeçar, dhe për fat organizata "Hendikos" e ka pasur një projekt, e ka iniciuar dhe është hartuar ai plan në bashkëpunim me anëtarët e Komitetit, përfaqësuesit e OJQ-ve lokale që veprojnë në komunën e Prishtinës, anëtarët me aftësi të kufizuar të pesë llojeve të AK-së, dhe kryetari i Komunës e ka caktuar një grup të rregullt punues të Komunës, që ka marrë pjesë në hartim. Kemi mbajtur grupe punuese me të gjitha dikasteret, drejtoritë komunale që kanë pasur përfaqësues, ku zakonisht ka qenë edhe Premtimja. Këtë Plan veprimi e kisha marrë me prioritet, për t'i parë ato problematikat, si me i shty me u realizuar ato pika kyçe në atë Plan veprimi trevjeçar. Për me realizuar këtë, kemi menduar me bërë një plan, me marr edhe një bashkëpunëtor të jashtëm, ndoshta ka me qenë trysni me i bërë Komunës për me shty atë plan.

Prej Planit të veprimit ka dalë që e kanë hartuar, se në komisionin për subvencione në Drejtori të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale është kërkuar një përfaqësuesi i OJQ-ve me qenë aty në atë ekip, e ata më kanë kërkuar mua, ku jam përfaqësuese në atë komision për subvencione, e që do të synoj në përmirësimin e shërbimit që kanë të bëjnë me mirëqenien e PAK.

Ne si Komitet i kemi marrë vendimet, nuk kemi detyra, përgjegjësi, por ne jemi këshill dhënës, grup konsultativ, mundemi me dhënë ide, me i shty idetë.

Jeton Tanhasi pyeti se a dihet sa ka Prishtina PAK, a ekzistojnë shënime statistikore.

Mehreme Llumnica u përgjigj, duke thënë se në Planin e veprimit ka qenë, do ta japim një kopje, ose do ta dërgojmë në mënyrë elektronike, aty ka munguar data-baza e PAK në Komunën e Prishtinës. Ndoshta kishte qenë një shtytje për me hartuar plane, kjo mungon në tërë Kosovën, e ne mundemi me shtyrë si iniciativë një donator për me krijuar një data-bazë, Komuna e Prishtinës me bashkëpunuar edhe me OJQ -të . Shoqata "Hendikos" e ka data-bazën për tërë komunën e Prishtinës.

Jeton Tanhasi tha se ata janë persona të cilët janë lajmëruar, por sa kemi ne persona që ngurohen me u lajmëruar, aty është esenca.

Premtime Preniqi shprehu besimin se do të bëhet regjistrim i mirëfilltë në Kosovë dha aty të regjistrohen.

Mehreme Llumnica tha se edhe në nivelin qendror kur të bëhet regjistrimi i popullatës, edhe nëse tash fillon me shty te hartimi i pyetësorit, me i përmirësuar ato rubrika se kanë qenë katastrofë, që nuk e kanë ditur çfarë lloji, a po flitet për të moshuar, për sëmundje organike, apo për lloje të AK, kështu që kishte me dalë një pasqyrë, duhet me i shty këto gjëra, ka pasqyra me dashtë me hulumtuar, ka të dhëna.

Gyltene Retkoceri tha se në statistika tjera, nëpër vende tjera thuhet se 20% e popullsisë është me nevoja të veçanta, por vetëm varet çfarë nevoja të veçanta, cilën shkallë.

Mehreme Llumnica, tha se e kam marrë një iniciativë, që edhe kjo duhet, p.sh. në QMF munden me mbajtur një evidencë, si për sëmundjen e kancerit që mbahen, për sëmundje kronike, por atyre kartelave shëndetësor u mungon një rubrikë, që janë sëmundjet organike, si për tension, diabet, ato që janë kronike, edhe aty ne duhet me bërë një iniciativë, me u specifikua lloji i aftësive të kufizuara, meqenëse edhe QMF-të e kanë marrë sipër listën e barnave esenciale. Ne duhet këto pikat kyçe me i prekur edhe prej nivelit qendror, edhe prej nivelit lokal, me u koordinuar pak, ne vetëm me i krahasuar, me i treguar ku i kemi gjetur ngecjet, mos përputhshmëria me nivelin lokal dhe qendror dhe me bashkëpunuar me Forumin e PAK dhe me Zyrën për qeverisje te mirë, ne me i treguar këto probleme.

Jeton Tanhasi pyeti se si qëndron Prishtina me qytetet tjera, ndoshta keni dhënë shembuj nëpër qytetet tjera.

Mehreme Llumnica u përgjigj, duke thënë se një përparësi e madhe është se është qendër, asgjë mos qoftë, është qendër informimi. Për shembull, Prishtina si për komitete, veprimtari të OJQ-ve, është njëra ndoshta më katastrofale se ka shumë OJQ, ka shumë qytetarë të viseve të krejt komunave, që ndoshta ata paguajnë tatimin në komunat e tyre e shërbimin e marrin në Prishtinë si qytetar me aftësi të kufizuara, si qytetarët tjerë.

Një problem që është më i madh, p.sh. ne na duhet me i synuar ato te qasja në infrastrukturë, p.sh. për parkingjet, për laurat (rampat), për shtigjet për të verbër, artikulimin me zërim për të shurdhrit apo me shenja, na duhet me i shtyrë, me iu bërë presion në Drejtorinë e Urbanizmit, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, që mos me iu dhënë leje apo mos me u bërë pranim-dorëzimi i asnjë objekti që nuk e ka qasjen fizike, se është edhe sipas Udhëzimit administrativ. Në Komunën e Prishtinës është edhe një Plan që e kanë bërë, edhe një raport ku janë pikat e caktuara, si shembull, i ka 200 taksi komuna e Prishtinës, kompani të taksistëve private, e asnjë, përveç një kompanie private "London Taxi", që e ka pasur qasjen për përdorues karroce, edhe ajo tani ka falimentuar. Pse të mos kushtëzohet një kompani, si "Geti", "Dallas" etj. kur i regjistrojnë 20 e më shurrë vetura, e merr leje për fushëveprim, pse mos me ia kushtëzuar 1-2 vetura, së paku me pasur të improvizuar qasje për përdorues karrocash. E njëjta çështje është edhe te punësimi.

Një kompani private i ka p.sh. 50 punëtorë, e merr një leje për fushë veprimtarinë për taksi, pse Komuna e Prishtinës mos me i vizitua, me shikuar a e ka një përdorues karroce apo një të verbët, të shurdhët etj. të punësuar.

Te punësimi, përveç me realizuar, me zbatuar, pse mos me marrë një stimulim Komuna e Prishtinës, një tatim pak më të lirë atij që ka PAK të punësuar, që kishte me i shtyrë edhe të tjerët për një veprim të tillë.

Premtime Preniqi tha se Komiteti ka pasur shumë përkrahje nga ish-drejtori i Administratës, z. Muhedin Nushi, tani nënkryetar i Komunës, dhe të njëjtën kohë d.m.th ju ka mundësua edhe udhëtimin pa pagesë të nxënësve që shkojnë në shkolla jashtë komunës së Prishtinës. E ka kërkuar listën prej Komitet, prej secilës aftësi të kufizuara, për me i futur në listën kur të jepet kontrata për sigurim, pastrim, këto janë gjëra që vetë drejtori ka marrë iniciativë.

Mehreme Llumnica, për strehimin, tha se në vitet e fundit, prej se ka filluar Komiteti, Drejtorja e Mirëqenies Sociale më shumë ka bashkëpunuar p.sh. edhe te strehimi, te këto banesat e sociale, kemi qenë në komision, ne kemi pasur të drejtë si vëzhgues me shkua në terren në analizim të lëndëve, po ka që ju kanë ndarë në mënyrë të barabartë shumë anëtarëve me aftësi të kufizuara, kanë qenë disa pikë për kritere. Ne duhet që përveç problemit të punësimit, me i shtyrë disa gjëra, si trashëgimia dhe prona, se asnjë PAK nuk e ka një pronë të caktuar, nuk ka prioritet në pronë.

Ramadan Salihu tha sfida më e madhe është me qenë PAK, d.m.th problemi kryesor i aftësisë së kufizuar është integrimi në shoqëri, sepse PAK në shoqërinë primitive, siç jemi ne, është i ndarë prej shoqërisë, nuk duhet PAK me u mjaftua me një biletë të autobusit, se a e shfrytëzon një herë në muaj apo në vite dhe ajo kushton 40 centë. Shtetet skandinave thonë vetëm a do t'i të punosh. Problemi kryesor është se në Skandinavi PAK nuk dëshirojnë me punuar, sepse i kanë benificionet e mëdha, se jo që nuk i punëson shteti, e te ne shteti nuk tregon vullnet për me i punësuar, arsyetimi në ligj, ajo është mos njohje e ligjit dhe fshehja pas tij, se Ligji asgjë nuk pengon. Unë i kam bërë pyetje nënkryetarit, se çka bëhet në qoftë se ti e punëson një PAK, askush nuk ka me të sanksionuar se e ke punësuar një PAK, dhe jam shumë i bindur se as kundër kandidati nuk ka me ushtrua padi në gjykatë, por një gjë të tillë shoqëria jonë nuk është e gatshme ta pranojë. Shoqëria jonë që është pjesë e shtetit, duhet me u vetëdijesuar që këta njerëz janë pjesë e tyre dhe këta duhet me i sistemuar në radhët e veta.

Gyltene Retkoceri u shpreh e pajtimit me zotëri Ramadanin, se problemi te ne është krejt te shteti, se nëse shteti do të bënte trysnia, atëherë do të veprohej ndryshe.

Premtime Preniqi tha se mungesa e vendeve të lira të punës e bën këtë, sepse kemi me mijëra njerëz të papunë.

Ramadan Salihu u shpreh se unë besoj se edhe zonja Fatime, që e ka marrë sot drejtimin e Komitetit, që jemi të barabartë, kryesuesja i ka do obligime më të mëdha, e këtë duhet me shty integrimin e individit, se shoqatat shikojnë vetëm për fonde.

Vetëm shoqatave sa kerret ua ka dhënë Komuna dhe për prishjen më të vogël ata nuk kanë fonde me i rregulluar, në vend se ato mjete me i koncentruar se si këtyre njerëzve me ua gjetur një integrim, një punë, se ka mundësi, gjithsesi ka, po nuk dëshirojnë, mungon vullneti shoqëror.

Fatime Demolli - Mustafa tha se unë e kisha caktuar takimin e rrallës më 3 tetor, pasi kemi pauzuar shumë, dhe në takimin e rrallës me pasur secili prej nesh Planin e veprimit dhe me diskutuar se cilat pika po dëshirojmë me filluar tutje në takimet e ardhshme. E kam në e-mail dhe të gjithëve ua dërgoj. Deri në këtë datë unë po provoj me u taktuar me drejtoreshën e Administratës, zonjën Vasilika Zotaj, për çështjen e kartelës identifikuese, në mënyrë që më 3 tetor, kur ta mbajmë takimin tjetër, me ua dhënë një përgjigje, e për takimet tjera diskutojmë tutje.

Ramadan Salihu tha se këtë takim e caktuam kështu, por kisha preferuar takimet e ardhshme me u caktuar ashtu siç i parasheh programi i punës.

Mbledhja përfundoi në orën 11:15.

Procesmbajtësja:
Shyhrete Islami

Kryesuesja e Komitetit
Fatime Demolli - Mustafa



